



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2024:074276

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05535328

**P.nr.165/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, , në lëndën penale të akuzuarit Sh. M. nga F... K..., i akuzuar për veprën penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 393 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.101/24F të datës 06.03.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 21.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta, të dëmtuarës Rr. B. dhe i akuzuari Sh. M. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av Petrit Lladrovci, me datë 25.03.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 02.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Sh. M, i biri i Xh..... dhe nëna H....., e gjinisë R..... i lindur me ....., në G..... me vendbanim në Rr. “.....” Fshati M. e P..... KK F... K....., me numër personal ....., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Më dt. 20.01.2024 dhe më datë 21.01.2024 rreth orës 11:00, i pandehuri Sh. M. ka shkelur Urdhrin Mbrojtës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Fushë Kosovë me numër C.nr. 277A/23 i datës 02.11.2023 me të cilin Urdhër i ndalohet palës përgjegjëse të pandehurit Sh. M. që palën e mbrojtur tani të dëmtuarën bashkëshorten e tij Rr. B, ta shqetësoj, ofendoj, përlulë, godas, kërcënoj, sulmoj, ndjek, përcjellë, shkatërroj apo kërcënoj pronën e tyre, mbajë nën vëzhgim, ndaloj lëvizjen palës së mbrojtur në, atë mënyre që më dt.20.01.2024 deri sa ishin në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare kishte filluar që ta shanë dhe ofendon me fjalë banale të dëmtuarën ,duke i bërë presion psikik dhe duke i hedhur rrobat e tija nga dollapi dhe duke e detyruar të dëmtuarën që ti palon përsëri sipas mënyrës që ka kërkuar ai ,pastaj të nesërmen më dt.21.01.2024 rreth orës 11:00 e ka sharë dhe ofenduar të dëmtuarën ,duke i bërtitur të njëjtës dhe fëmijëve pa ndonjë arsye ,me ç’ rast tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madh emocional, ankth, frikë dhe e raporton rastin në polici.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 393 par 1 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

## DËNIM ME GJOBË

- I. Ne shumën prej 400.00 (katërqind) Euro te cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar Rr. B. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet që ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.101/24F të datës 06.03.2024, ndaj të akuzuarit Sh. M. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Mospërfillja e Gjykatës nga neni 393 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta, të pandehurit Sh. M. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Petrit Lladrovci dhe të dëmtuarës Rr. B., ku i pandehuri u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit, të dëmtuarës dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të

akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit Sh. M. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Mospërfillja e Gjykatës neni 393 par 1 të KPPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, Ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 43 të KPPRK-së të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtes të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.165/24 datë 02.04.2024

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.